Shënimet për Pasqyrat Financiare

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria Grant Thornton është shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar e krijuar me 23.07.2009 në përputhje me Ligjin "Për Shoqëritë Tregtare".

Aktiviteti kryesor i shoqërisë është dhënia e shërbimeve te auditimit, konsulencës për taksat dhe shërbime kontabiliteti.

Administrator i shoqërisë është Z. Kledian Kodra. Me 31 dhjetor 2023 shoqëria kishte 38 punonjës (31 dhjetor 2022: 36 punonjës).

Selia qëndrore e shoqërisë është në adresën: Rr "Sami Frashëri", Kompleksi T.I.D, Shk. B, Kati 1, Tiranë. Ajo është regjistruar si person i tatueshëm në rrethin e Tiranës me numër identifikimi të personit të tatueshëm K91923007M.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023 janë aprovuar nga administratori më 27 mars 2024

2. Bazat e Përgatitjes së Pasqyrave

2.1 Bazat e Përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) dhe ligjit nr. 25/2022, date 10.05.2022 "Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare". Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike. Këto pasqyra financiare janë prezantuar në Lekë, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.2 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon nga drejtuesit të ushtrojnë gjykimin e tyre në procesin e zbatimit të politikave kontabël të shoqërisë dhe shumave të raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultati aktual mund të ndryshojë në varësi të këtyre vlerësimeve.
Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyre të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve dhe gjykimeve në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Aktive afatgjata materiale

(i) *Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.
Fitimet dhe humbjet nga shitjet apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur, dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave.

(ii) *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

(iii) *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit, mbi jetën e vlerësuar të çdo pjesë të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes.

Amortizimi vjetor i aktiveve është si më poshtë:

Aktive të qëndrueshme	**%**
Ndërtesa	5
Makineri dhe pajisje	20
Automjete	20
Pajisje zyre dhe të tjera	20
Kompjutera dhe pajisje IT	25

Jetëgjatësia e aktiveve dhe vlera e mbetur rishikohet në çdo datë raportimi.

3.2 Llogari e kërkesa të tjera të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizioni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arketueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës se mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3.3 Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

3.4 Paraja dhe ekuivalentet e saj

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse në monedhën Lek dhe Euro.

3.5 Veprimet në monedhë të huaj

Veprimet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Asetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit sipas kursit të Bankës së Shqipërisë. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetare është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikembehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi zyrtar i këmbimit për Euro dhe Lek në fund të vitit paraqitet si më poshtë:

	31 Dhjetor 2023	31 Dhjetor 2022
1 EUR	103.88	114.23

3.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundshme që përfitimet e ardhshme ekonomike do ti vijnë kompanisë dhe këto përfitime mund të maten në mënyrë të besueshme. Shpenzimet njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato kryhen. Të ardhurat dhe shpenzimet regjistrohen në pasqyrat financiare të periudhës të cilës i përkasin.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar në ligjin në fuqi për "Tatimin mbi fitimin" Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin të gjithë barrën për vitin korrent. Tatimi mbi fitimin llogaritet si 15 % e të ardhurave të tatueshme si është përcaktuar në SKK dhe legjislacionin Shqiptar.

3.10 Parimi i vijueshmërisë

Pasqyrat financiare të Shoqërisë janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimësisë, i cili supozon se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e saj operacionale për të ardhmen e parashikueshme. Në kryerjen e këtij gjykimi, drejtimi kreu një analizë të hollësishme duke marrë në konsideratë të gjitha faktet dhe rrethanat në dispozicion dhe pozicionin financiar të entitetit, qëllimet aktuale, përmirësimin e pritshëm të përfitimit të operacioneve dhe aksesin në burimet financiare, në përputhje me parimin e vijimësisë në të ardhmen e parashikueshme. Në të ardhmen e parashikueshme drejtimi merr në konsideratë të gjitha informacionet e disponueshme për të ardhmen të cilat janë të paktën, por nuk kufizohet në dymbëdhjetë muaj nga përfundimi i periudhës së raportimit. Përfundimi nga analiza e mësipërme është që entiteti nuk përballet me ndonjë problem operimi dhe nuk parashikon ndonjë të tillë deri në fund të vitit pasardhës.

4. Mjetet monetare

Mjetet monetare përbëhen nga Paraja dhe ekuivalentet e parasë dhe janë analizuar si më poshtë:

	2023 LEK	2022 LEK
Arka	**77,163**	**44,757**
- në Lek	74,794	44,757
- në monedhë të huaj	2,369	-
Llogari rrjedhëse	**1,162,882**	**4,608,569**
- në Lek	200,210	962,579
- në monedhë të huaj	962,672	3,645,990
Garanci bankare	-	-
	1,240,045	**4,653,326**

5. Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme më 31 Dhjetor 2023 dhe 2022 paraqiten si në vijim:

	2023 LEK	2022 LEK
Klientë vendas	19,497,625	23,776,442
Provigjon	(4,368,602)	(3,555,980)
	15,129,023	**20,220,462**

6. Të tjera aktive afatshkurtra

Të tjera aktive afatshkurtra shpreh gjendjen e kapitalit për tu arkëtuar dhe parapagime të dhëna punonjësve.

	2023 LEK	2022 LEK
Garanci dhënë të tretëve	515,286	565,132
Abonim i parapaguar dhe anëtarësime	29,274	29,274
Tatimi mbi fitimin	2,607,366	1,662,175
Të tjera	1,263,191	3,078,921
Hua ndaj Grant Thornton Montenegro	3,116,400	-
	7,531,517	**5,335,502**

7. Aktive afatagjata materiale dhe jomateriale

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2023	Mobilje dhe paisje zyre	Paisje informatike	Mjete transporti	Permiresime te ambienteve me qira	Programe	Totali
	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK	LEK
Aktivet me kosto						
Gjendja me 1 janar	**4,098,070**	**6,037,386**	**863,003**	**3,369,512**	**969,731**	**15,337,701**
Shtesat	502,608	744,530	-	-	-	**1,247,138**
Pakësimet	-	-	-	-	-	**-**
Gjendja me 31 dhjetor	**4,600,678**	**6,781,916**	**863,003**	**3,369,512**	**969,731**	**16,584,839**
Amortizimi						
Gjendja me 1 janar	**2,343,123**	**2,637,928**	**778,061**	**702,684**	**634,112**	**7,095,908**
Shtesat	414,939	979,595	24,920	133,341	74,470	**1,627,265**
Pakësimet	-	-	-	-	-	**-**
Gjendja me 31 dhjetor	**2,758,062**	**3,617,523**	**802,981**	**836,025**	**708,582**	**8,723,173**
Vlera e mbetur me 1 janar	**1,754,947**	**3,399,457**	**84,942**	**2,666,828**	**335,619**	**8,241,793**
Vlera e mbetur me 31 dhjetor	**1,842,615**	**3,164,392**	**60,022**	**2,533,487**	**261,149**	**7,861,667**

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2022	**Mobilje dhe paisje zyre**	**Paisje informatike**	**Mjete transporti**	**Permiresime te ambienteve me qira**	**Programe**	**Totali**
	LEK	**LEK**	**LEK**	**LEK**	**LEK**	**LEK**
Aktivet me kosto						
Gjendja me 1 janar	**3,448,169**	**4,669,152**	**863,003**	**3,369,512**	**969,731**	**13,319,567**
Shtesat	649,900	1,368,234	-	-	-	**2,018,134**
Pakësimet	-	-	-	-	-	**-**
Gjendja me 31 dhjetor	**4,098,069**	**6,037,386**	**863,003**	**3,369,512**	**969,731**	**15,337,702**
Amortizimi						
Gjendja me 1 janar	**2,121,325**	**1,974,090**	**756,825**	**562,324**	**509,515**	**5,924,080**
Shtesat	221,798	663,838	21,236	140,359	124,597	**1,171,828**
Pakësimet	-	-	-	-	-	**-**
Gjendja me 31 dhjetor	**2,343,123**	**2,637,928**	**778,061**	**702,684**	**634,112**	**7,095,908**
Vlera e mbetur me 1 janar	**1,366,845**	**2,695,061**	**106,178**	**2,807,188**	**460,216**	**7,395,487**
Vlera e mbetur me 31 dhjetor	**1,754,946**	**3,399,457**	**84,942**	**2,666,828**	**335,619**	**8,241,793**

8. Të pagueshme ndaj furnitoreve

Të pagueshme ndaj furnitorëve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023 dhe 2022 paraqitet si vijon:

	2023 LEK	2022 LEK
Furnitorë	429,547	1,827,118
Parapagime të marra	101,169	101,169
Shpenzime të llogaritura	385,603	-
Palë të lidhura	398,899	438,743
Dividend i pagueshëm	7,883,100	-
Të tjera	606,304	498,562
	9,804,483	**2,871,240**

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore janë analizuar si më poshtë:

	2023 LEK	2022 LEK
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	1,219,677	883,875
Tatimi mbi të ardhurat personale	700,082	399,407
TVSH për tu paguar	1,549,554	1,310,423
Tatim në burim	79,709	94,844
	3,549,022	**2,688,549**

10. Kapitali

Grant Thornton është Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me kapital prej 1,908,100 Lekë. Kuotat e kapitalit jane 2 dhe njera perfaqeson 20% te kapitalit dhe zotërohet nga shoqëria e auditimit Grant Thornton Consulting Doo, Shkup, Maqedoni dhe tjetra kuote perfaqeson 80% te kapitalit dhe zoterohet nga Z. Kledian Kodra.

11. Të ardhurat

Të ardhurat janë analizuar si më poshtë:

	2023 LEK	2022 LEK
Të ardhurat	119,668,129	103,513,064
Të ardhura të tjera	267,559	-
Totali	**119,935,688**	**103,513,064**

12. Kosto e punës

Kosto e punës është analizuar si më poshtë:

	2023 LEK	2022 LEK
Paga dhe shpërblime	63,338,346	40,856,051
Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	7,918,598	5,280,480
Totali	**71,256,944**	**46,136,531**

13. Shpenzime administrative dhe të tjera

Shpenzime administrative dhe të tjera jane analizuar si më poshtë:

	2023 LEK	2022 LEK
Shpenzime antarësimi dhe ente rregullator	4,468,072	4,264,631
Qera	5,249,790	3,703,948
Shpenzime konsulence	2,737,905	1,375,923
Shpenzime nga kontratat e bashkëpunimit	548,610	1,626,150
Shpenzime IT	4,529,929	1,350,687
Shpenzime utilitare	566,781	382,957
Mirëmbajtje dhe shpenzime sigurimi	625,877	573,390
Udhëtime dhe dieta	1,457,260	729,701
Kancelari	793,615	711,789
Shpenzime postare dhe komunikacioni	524,051	489,166
Shpenzime personeli	783,202	480,131
Shpenzime transporti	199,492	322,406
Taksa lokale	49,500	49,500
Shpenzime trajnimi	165,808	301,236
Sponsorizime	288,865	611,814
Gjoba	18,786	12,597
Komisione bankare	184,939	197,564
Shpenzime të tjera	2,985,089	1,488,890
Totali	**26,177,571**	**18,672,480**

14. Fitime / (humbje) nga kurset e këmbimit

Fitime / (humbje) nga kurset e këmbimit janë analizuar si më poshtë:

	2023 LEK	2022 LEK
Fitime nga kurset e këmbimit	2,147,974	1,716,040
Humbje nga kurset e këmbimit	(3,188,040)	(2,650,892)
	(967,437)	**(934,852)**

15. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Bazuar në legjislacionin Shqiptar, norma e tatimit mbi fitimin është 15% për vitin 2023 (15% për vitin 2022).

Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruara për qëllime tatimi konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe regjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore Shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore. Në vitin 2023 Shoqëria ka rezultuar me një fitim/(humbje) kontabël dhe fiskal si më poshtë:

		2023 LEK	2022 LEK
1	**Fitimi para tatimit**	**19,906,472**	**36,597,373**
2	*Shpenzime te pazbritshme (të listuara më poshtë):*	**2,938,175**	**836,068**
	Gjoba	18,786	12,597
	Shpenzime utilitare	297,964	124,237
	Shpenzimi per argetimin e personelit	422,298	-
	Shpenzime të tjera	2,199,127	699,234
3	**Të ardhura rimarrje nga borxhi i keq**	**-**	**-**
4	**Fitimi fiskal (1+2+3)**	**22,844,647**	**37,433,441**
5	**Humbjet e mbartura (-)**	**-**	**-**
6	**Norma e tatim fitimit**	15%	15%
7	**Tatim fitimi i vitit**	**3,426,697**	**5,615,016**
8	**Shpenzim i tatim fitimit**	**3,426,697**	**5,615,016**

16. TRANSAKSIONET ME PALËT E LIDHURA

Palët konsiderohen të lidhura nëse njëra prej tyre mund te kontrollojë ose te ushtrojë ndikim te konsiderueshëm në marrjen e vendimeve operative dhe financiare të palës tjetër.
Gjatë marrjes në konsideratë të çdo marrëdhënie të mundshme midis palëve, vëmendje i kushtohet përmbajtjes së marrëdhënies dhe jo thjesht formës ligjore.

Në çdo datë raportimi, Shoqëria ka balancat e mëposhtme me palët e lidhura:

	Të arkëtueshme LEK	Detyrime LEK	Të ardhura LEK	Kosto LEK
31 Dhjetor 2023				
Grant Thornton Doo		-		4,171,902
Grant Thornton Consulting Doo		-	913,570	-
	-	**-**	**913,570**	**4,171,902**
31 Dhjetor 2022				
Grant Thornton Doo		-		2,692,079
Grant Thornton Consulting Doo		-	3,018,787	-
	-	**-**	**3,018,787**	**2,692,079**

17. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Drejtimi i Shoqërisë nuk është në dijeni të ndonjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit që do të kërkonte të ndryshoheshin shënimet në pasqyrat financiare.